

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT
PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

RAPORTI VJETOR 2022

PËRMBAJTJA

I. HYRJA	3
I.I Objektivat e AKAFPK-së	3
I.II Funksionet e AKAFPK-së	3
II. PËRMBLEDHJE	3
II.I Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së	3
II.II Zbatimi i projektit “EPALE National Support Services 2022-2024” /Erasmus+.....	4
II.III Marrëveshja e Grantit 614329-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA3-AL-AGENDA “National Coordinators for the Implementation of the EU Adult Learning Agenda”, në programin Erasmus+.....	5
II.IV Problematikat	5
III. VEPRIMTARITË E DETAJUARA TË SEKTORËVE	6
III.I Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale.....	6
III.I.I Veprimtari lidhur me Profesionet	6
III.I.II. Veprimtari lidhur me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve	7
III.I.III Bashkëpunimi me ofrues të AFP-së dhe biznese	8
III.I.IV Aktivitete të tjera.....	9
III.II Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të AFP-së	10
III.II.I Veprimtaria dhe kontributet e Sektorit të HKMM	10
III.II.II Veprimtaria dhe kontributet e Sektorit të ZHVP	12
III.II.III Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimeve	14
III.II.IV Veprimtari të tjera.	15
III.III Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së	16
III.III.I Zhvillimi i Procesit të vetëvlerësimit të IoAFP-ve	16
III.III.II Pilotimi i Procesit të Akreditimit	17
III.III.III Informim në lidhje me procesin e akreditimit	19
III.III.IV Të tjera	21
III.IV Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve	21
ANEKSE.....	27
Aneks 1: Produkte që lidhen me profesionet	27
Aneks 2: Standarde të Kualifikimeve Profesionale	28
Aneks 3: Programe Orientuese.....	28
Aneks 4: Suplemente të Certifikatave dhe plane mësimore	29
Aneks 5: Skeletkurrikula të Arsimit Profesional.....	30
Aneks 6: Programe lëndore, module profesionale, programe Kursesh të Unifikuara.....	31
Aneks 7: Materiale mësimore dhe udhëzuesa	32

I. HYRJA

AKAFPK-ja ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

I.I Objektivat e AKAFPK-së

Në përmbushje të këtij misioni, Agjencia synon të arrijë objektivat e mëposhtme:

- Zhvillimin e AFP në lidhje me nevojat e teknologjisë moderne, tregun e punës dhe zhvillimin social të vendit.
- Sigurimin e partneritetit social në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së.
- Integrimin e arsimit, formimit dhe punës në këndvështrimin e të nxënësve gjatë gjithë jetës.
- Zhvillimin e dimensionit evropian të AFP-së duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit të kompetencave me tregun e përbashkët evropian.
- Zhvillimin e instrumenteve për realizimin e politikave për zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Hartimin e instrumenteve për zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AFP-së.

I.II Funksionet e AKAFPK-së

Në përmbushje të misionit të saj, AKAFPK-ja kryen funksionet e mëposhtme:

- Harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, Listën Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale, nivelet dhe standardet përkatëse.
- Harton dhe rishikon skelet-kurrikulat e kualifikimeve profesionale.
- Harton dhe rishikon standardet e trajnimit të mësimdhënësve të AFP-së.
- Përcakton parimet dhe kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për kualifikimet profesionale.
- Akrediton institucionet e AFP për kualifikimet profesionale.
- Siguron që standardet e kompetencave të jenë në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, në veçanti me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe Sistemin Evropian të Krediteve për AFP-në.
- Siguron bashkëveprimin e të gjithë aktorëve kontribues të shoqërisë, në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së.

I.III Akronime

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKP	Agjencia Kombëtare e Provimeve
ETF	European Training Foundation (Fondacioni Evropian i Trajnimeve)
DRFPP	Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik
ISCED në Arsim)	International Standard for Classification in Education (Standardi Ndërkombëtar për Klasifikim në Arsim)
ILO	International Labor Organisation (Organizata Ndërkombëtare e Punës)
IoAFP	Institucione Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
LKP	Lista Kombëtare e Profesioneve
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
SSHMP	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve
SHKMM	Spektori i Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse
SZHVP	Spektori i Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Mësuesve të AFP
DPKP	Drejtorja e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale
DZHPO	Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të AFP-së
SA	Spektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së



II. PËRMBLEDHJE

II.I Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së

Veprimtaria e AKAFPK-së është mbështetur në Planin e punës të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm për vitin 2022 si dhe në kërkesat e nevojat e pa planifikuara. Në fokus të veprimtarive ka qënë jo vetëm përmbushja e objektivave për aspektet sasiore të produkteve të planifikuara, por edhe garantimi i cilësisë së proceseve dhe produkteve përkatëse.

Agjencia e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) ka koordinuar veprimtarinë me MFE-në dhe Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për të lehtësuar përdorimin e Listës Kombëtare të Profesioneve të përditësuar, miratuar me VKM nr. 514, datë 20.09.2017. Gjithashtu, është ofruar këshillim dhe orientim për të interpretuar rubrika të LKP-së sipas kërkesës së përdoruesve të ndryshëm duke lehtësuar aksesin për të gjithë përdoruesit.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.06.2019 “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Komiteteve Sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre”, është ngritur Komiteti Sektorial i Mikpritjes dhe Turizmit me Urdhrin e përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit” nr. 163, datë 06.06.2022.

Në këtë kuadër është bërë përzgjedhja e anëtarëve të Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit, përfaqësues të biznesit, kompetencë e AKAFPK-së. Krahas kësaj, janë emëruar përfaqësuesit e ministrive dhe të sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) që veprojnë në fushën e mikpritjes dhe turizmit. Komiteti do të shërbejë si një mekanizëm për lidhjen e tregut të punës me ofertën e AFP-së dhe në adresimin e mungesave dhe kërkesave të aftësive nga tregu i punës drejt ofruesve të AFP-së.

Ndër arritjet dhe produktet kryesore të realizuara nga AKAFPK gjatë vitit 2022 mund të përmendim:

- Janë përshtatur 10 përskrime profesionale, si bazë për hartimin e kurseve afatshkurta dhe janë finalizuar 21 standarde profesionale, nga të cilat 1 është standard rajonal profesionale për Ballkanin Perëndimor. (Aneks 1)
- Janë zhvilluar 20 standarde të kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së. (Aneks 2)
- Janë hartuar dhe rishikuar 21 Programe orientuese të kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së. (Aneks 3)



- Janë hartuar dhe rishikuar 19 Suplemente të certifikatave të kualifikimeve profesionale, si dhe është punuar për plotësimin e 15 planeve mësimore të kualifikimeve profesionale të reja dhe të rishikuara të ofruara në vitin shkollor 2022-2023 (Aneks 4)
- Janë hartuar 3 skeletkurrikula të reja të kualifikimeve profesionale si dhe janë rishikuar për përmirësim 20 skeletkurrikula (për vitet shkollore 2022-2023 dhe 2023-2024). (Aneks 5)
- Është rishikuar 1 program i lëndës profesionale “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12, si dhe janë hartuar 2 module profesionale, “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm”, kl. 12 dhe kl. 13. Gjithashtu, janë hartuar 10 programe për Kurset e Unifikuara të FP, bazuar edhe në përshkrimet apo standardet e profesioneve përkatëse. (Aneks 6)
- Janë hartuar 25 materiale mësimore mbështetëse të lëndëve profesionale të AP dhe janë përgatitur 3 udhëzues . (Aneks 7)
- Në kuadër të formimit fillestar të mësimdhënësve të kulturës profesionale u koordinua dhe harmonizua kursi i trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP”, ku morën pjesë dhe u certifikuan me sukses 34 mësimdhënës nga ofrues publik të AP.
- U administrua Kualifikimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit publikë të AFP, ku morën pjesë 64 mësimdhënës nga ofrues publik të AFP, nga të cilët u certifikuan 56 mësimdhënës.
- U realizua mbështetja e ofruesve në trajnimin e përdorimit të platformës elektronike të vetëvlerësimit, si dhe finalizimi i procesit të vetëvlerësimit për 44 institucione publike dhe 1 ofrues jo publik.
- U realizua pilotimi i procesit të akreditimit, bazuar në gatishmërinë e ofruesit për akreditim, ku u përfshinë pesë institucione publike dhe një ofrues jo publik i arsimit profesional, duke përzgjedhur kualifikime profesionale nga oferta e tyre arsimore.
- Në kuadër të fillimit të procesit të akreditimit u organizuan pesë takime rajonale, me pjesëmarrjen e 44 IoAFP-ve, në qytetet Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë.
- AKAFPK ka realizuar aktivitetet dhe ka ndjekur korrespondencat zyrtare në kuadër të zbatimit të tre projekteve: EPALE NSS 2022-2024, ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA dhe ERASMUS-EDU-2022-CB-VET.

Krahas sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, AKAFPK në bashkëpunim me DAP ka vijuar me procesin e rekrutimit të stafit për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e re. Gjatë 2022, si rrjedhojë e konkurrimit për pozicionet vakante të AKAFPK-së, në lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë apo konkurrimin nga jashtë shërbimit civil, janë plotësuar 7 pozicione, nga të cilat 1 drejtor drejtorie, 2 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë.

II.II Zbatimi i projektit “EPALE National Support Services 2022-2024”

/Erasmus+

Si qendër kombëtare mbështetëse e emëruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, AKAFPK ka nënshkruar Marrëveshjen e Grantit për promovimin e Platformës Elektronike për të Nxënërit e të Riturve në Evropë (EPALE) në periudhën 2021-2022.

Gjatë vitit 2022, në zbatim të planit të punës së këtij projekti, janë organizuar takime me institucione ofruese, politike bërës dhe organizata në fushën e të nxënimit të të rriturve. Në vijim janë organizuar tre takime rajonale të zhvilluara në Shkoder dhe Tiranë. Takimet rajonale janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, me përfaqësues të pushtetit lokal, bashki dhe prefektura, drejtori arsimore, universitete, si dhe aktorë të tjerë që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në kuadrin e arsimit të të rriturve.

Pjesëmarrësit ishin aktivë dhe të interesuar të njiheshin me Platformën EPALE si dhe prioritetet dhe zhvillimet në sektorin e të nxënimit të të rriturve. Për promovimin e Platformës EPALE, takime informuese janë zhvilluar edhe në kuadrin e veprimtarive të organizuara nga partnerët të të tjerë, si p.sh në kuadrin e javës së aftësive të zhvilluar në Tiranë, etj.

Gjithashtu, në zbatim të këtij projekti janë publikuar në këtë platformë elektronike, si dhe në rrjetet sociale artikuj, lajme, studime mbi të nxënimit e të rriturve, sipas indikatorëve të përcaktuar nga donatori.

Lidhur me menaxhimin teknik e financiar të këtij projekti, AKAFPK raporton periodikisht Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu, gjatë këtij viti AKAFPK përgatiti raportin e perfundimtar për projektin e zbatuar fazes së mëparshme.

II.III Marrëveshja e Grantit 614329-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA3-AL-AGENDA “National Coordinators for the Implementation of the EU Adult Learning Agenda”, në programin Erasmus+

Gjatë këtij viti, ka vijuar zbatimi i projektit për zhvillimin e konceptit për ngritjen kapaciteteve në mësimin e kombinuar të instruktoreve në Ofruesit e FP-së. Është zhvilluar një studim për gjendjen e omësimit të kombinuar dhe qasjen në vendin tonë, duke patur si qëllim analizën e situatës, problemet dhe sfidat në zhvillimin e nje qasje të mësimin të kombinuar në AP të harmonizuar me zhvillimet e tjera në vendin dhe në botë. Draft studimet janë prezantuar në konferencën e organizuar në kuadrin e javës së të nxënimit gjatë gjithë jetës “Aftësi të dhe profesionet e së ardhmes”.

II.IV Problematikat

Miratimi i strukturës dhe organikës së propozuar nga AKAFPK do të mbështesë modernizimin e KSHK-së rritjen e zbatueshmërisë së saj në kuadrin e përafrimit të këtij kuadri ligjor me rekomandimet e Këshillit Evropian të 22 majit 2017 për “Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të nxënimit gjatë gjithë jetës” (2017 / C 189/03), si dhe zhvillimin cilësor të ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional me ngritjen



e sistemit të kualifikimit të vazhduar të personelit mësimdhënës në AFP. Sfide mbetet plotësimi me prioritet i vendeve të lira ne organikë.

III. VEPRIMTARITË E DETAJUARA TË SEKTORËVE

III.I Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

III.I.I Veprimtari lidhur me Profesionet

a) Standardet e Profesioneve

Edhe gjatë këtij viti, fokusi i veprimtarisë së sektorit në kuadrin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP) ka qenë mbështetja e përdoruesve të saj. Sektori ka mbështetur dhe orientuar përdorues të ndryshëm përmes materialeve informuese të LKP-së në format tekst dhe në format elektronik. Janë zhvilluar takime orientuese me subjekte të interesuara për përdorimin dhe interpretimin e informacionit të LKP-së. Gjithashtu, është koordinuar puna me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) për të përdorur informacionin e LKP-së në sistemin e tyre të informacionit. Janë zhvilluar takime në rajone të ndryshme, kryesisht në institucionet ofruese të AFP-së për të promovuar LKP-në dhe lehtësuar përdorimin e saj me qëllim të orientimit më të mirë në tregun e punës.

Në mbështetje të procesit të zhvillimit të kurrikulës për kurse afatshkurtra të unifikuara është identifikuar nevoja për këto kurse në bashkëpunim me AKPA-n, si dhe është përshtatur informacioni i 10 përshkrimeve të profesioneve. Këto të dhëna mbi profesionet kanë shërbyer si dokument bazë për hartimin e kurrikulave për kurset afatshkurtra të unifikuara.

Gjithashtu, janë hartuar 21 standarde profesionale me përfaqësues të bizneseve dhe mësimdhënësve të AFP, 2 nga të cilët janë zhvilluar me mbështetje e projektit “Skills for Jobs”, 1 me mbështetjen e projektit Italian “PEMA” dhe 1 është standard rajonal profesionale për Ballkanin Perëndimor me mbështetje të ERI SEE. (Aneks 1)

b) Komitetet Sektoriale

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.06.2019 “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Komiteteve Sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre”, është ngritur Komiteti Sektorial i Mikpritjes dhe Turizmit me



Urdhri e përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Mikëpritjes dhe Turizmit” nr. 163, datë 06.06.2022.

Në këtë kuadër është bërë përzgjedhja e anëtarëve të Komitetit Sektorial të Mikëpritjes dhe Turizmit, përfaqësues të biznesit, kompetencë e AKAFPK-së. Krahas kësaj, janë emëruar përfaqësuesit e ministrive dhe të sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) që veprojnë në fushën e mikëpritjes dhe turizmit. Komiteti do të shërbejë si një mekanizëm për lidhjen e tregut të punës me ofertën e AFP-së dhe në adresimin e mungesave dhe kërkesave të aftësive nga tregu i punës drejt ofruesve të AFP-së.

Me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), u zhvillua takimi prezantues për krijimin e Komitetit Sektorial të Mikëpritjes dhe Turizmit. Gjatë këtij takimi u prezantua qëllimi, funksionet, proceset dhe pritshmëritë e këtij Komiteti, si dhe përvoja ndërkombëtare për veprimtarinë e Komiteteve Sektoriale.

Sekretariati Teknik i Komiteteve Sektoriale pranë AKAFPK-së, ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, ka mbështetur aktivitetin e Komitetit Sektorial TIK për organizimin dhe mbarëvajtjen e 4 takimeve të tij.

III.I.II. Veprimtari lidhur me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve

a) *Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale*

Me Urdhër nr. 289, datë 29.12.2022 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 99 datë 25.05.2021 të MFE, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale” janë miratuar ndryshime në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale për nivelet 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, i cili përfshin emërtimin e kualifikimeve profesionale, nivelin përkatës në KSHK, volumin e të nxënit, kohëzgjatjen e periudhës së miratimit, si dhe anekse të dokumenteve zhvillimore që shoqërojnë çdo kualifikim profesional, standardet (përshkruesit) përkatëse për secilin kualifikim në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat, të bazuara në rezultate të nxënit.

b) *Standardet e Kualifikimeve Profesionale*

Gjatë këtij viti, janë hartuar dhe rishikuar 20 standarde të kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së të cilat janë zhvilluar, në terma të rezultateve të të nxënit për njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat më të përgjithshme në përputhje më përshkruesit e niveleve të KSHK-së dhe mbështetur në standardet e profesioneve përkatëse. Në këtë proces janë angazhuar



mbi 100 bashkëpunëtoresh duke përfshirë përfaqësues të bizneseve të ndryshme, por edhe mësimdhënës të shkollave profesionale. (Aneks 2)

c) Programe Orientuese (PO)

Gjatë viti 2022, janë hartuar dhe rishikuar 21 Programe orientuese të kualifikimeve profesionale, nga të cilat 6 PO të Maturës Shtetërore Profesionale dhe 15 PO të niveleve 2-5 të KSHK-së. Në këtë proces janë angazhuar mbi 60 bashkëpunëtorë, përfaqësues të bizneseve të ndryshme dhe mësimdhënës të shkollave profesionale. (Aneks 3)

d) Suplemente të certifikatave

Gjatë këtij viti, janë hartuar dhe rishikuar 19 Suplemente të certifikatave të kualifikimeve profesionale, si dhe është punuar për plotësimin e 15 planeve mësimore të kualifikimeve profesionale të reja dhe të rishikuara të ofruara në vitin shkollor 2022-2023, informacion ky i kërkuar nga QSHA. (Aneks 4)

III.I.III Bashkëpunimi me ofrues të AFP-së dhe biznese

Për efekt të monitorimit të cilësisë së Arsimit dhe Formimit Profesional dhe në mbështetje të ofruesve të Arsimit Profesional (AP), u planifikua realizimi i një sërë takimesh me mësimdhënës të shkollave profesionale. Takimet u zhvilluan përgjatë periudhës tetor - nëntor 2022 në shkollat:

Shkolla “Beqir Çela”, Durrës
Shkolla “Hysen Çela”, Durrës
Shkolla “Charles Telford Erickson”, Golem
Shkolla “26 Marsi”, Kavajë
Shkolla “Hasan Dervish Gina”, Lushnjë
Shkolla “Kristo Isak”, Berat
Shkolla “Stijano Bandilli”, Berat
Shkolla “Mihal Shahini”, Cërrik
Shkolla “Salih Ceka”, Elbasan
Shkolla “Ali Myftiu”, Elbasan
Shkolla “Hoteleri - Turizëm”, Tiranë
Shkolla “Karl Gega”, Tiranë

Gjithashtu, u zhvilluan dhe takime me përfaqësues të biznesit mes tyre dhe Autoriteti Portual i Durrësit.

Qëllimi i këtyre vizitave ishte:



- Mbledhja e informacioneve për ecurinë e kualifikimeve profesionale dhe problematikat e hasura gjatë procesit të ofrimit të tyre.
- Identifikimi i nevojave të reja të kualifikimeve profesionale mbi bazën e kërkesave të tregut rajonal.
- Informimi i bizneseve lidhur me kualifikimet e ofruara nga shkollat profesionale, si dhe identifikimi i nevojave për kualifikime në fusha të ndryshme të aktivitetit të tyre.
- Diskutim mbi problematikat, nevojat për ndryshim të mëtejshëm, rekomandimet lidhur me programet orientuese të hartuara, cilësia e tyre dhe ndryshimet në programet e rishikuara.
- Mënyra e zbatimit të programeve orientuese, vështirësitë e hasura dhe cilësia e udhëzimeve metodike në lidhje me zbatimin e programeve orientuese.
- Identifikimi i nevojave për udhëzime apo mbështetje të mëtejshme për dokumentacionin e provimeve përfundimtare, si dhe sugjerime apo vërejtje për programet e matures shtetërore profesionale.
- Identifikimin e nevojave për trajnim të mësuesve lidhur me kualifikimet përkatëse.

Lidhur me këto vizita është përgatitur dhe një raport i hollësishëm i DPKP.

III.I.IV Aktivitete të tjera

Përfaqësues të sektorit kanë marrë pjesë në takime të ndryshme të organizuara nga institucione të ndryshme, të tilla si:

- Kontribut në grupin e punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, i ndryshuar.
- Pjesëmarrje në takimet për këshillim dhe diskutim për Kapitullin 2 “Liria e lëvizjes së Punëtorëve”, për kapitullin 3 “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”, nënkapitulli për “Profesionet e rregulluara”, të organizuara nga MAS, MFE dhe MEPJ.
- Pjesëmarrje në takime të projektit për komponentin e AFP-së “Rritja e cilësisë së arsimit dhe trajnimit në vendet e Evropës Juglindore” - projekti EQET. Projekti financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe do të zbatohet nga Iniciativa për Reformën Arsimore të Evropës Juglindore (ERI SEE).
- Pjesëmarrje në Konferencën Përmbyllëse të projektit të financuar nga BE “Asistenca Teknike për të Mbështetur Reformën mbi Politikën e Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional”, i cili zbatohet nga WEglobal Itali dhe partnerët e Konsorciumit të tij.
- Pjesëmarrje në kongresin për arsimin “Sfidat e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës drejt integritet evropian”. Qëllimi i këtij Kongresi ishte të bashkojë në një hapësirë diskutimi shumë aktorë në fushën e arsimit, përfshirë arsimin parauniversitar, arsimin e lartë, kërkimin shkencor, agjencitë, partnerët në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përfaqësues të shoqërisë civile dhe donatorët e projekteve në fushën e arsimit, etj.)



- Pjesëmarrje në takimet rajonale për zhvillimin e standardit rajonal të kualifikimit për Bujqësi tradicionale dhe organike, në kuadër të projekti “*Rritja e cilësisë së arsimit dhe trajnimit në Evropën Juglindore*” (EQET SEE).
- Pjesëmarrje në workshop-in “*Partneriteti Publik-Privat për plotësimin e nevojave për aftësi dhe për ta bërë arsimin dhe trajnimin profesional një rrugë tërheqëse mësimore*”, organizuar në Vjenë.
- Pjesëmarrje në workshop-in për inaugurimin e vitit të ri shkollor dhe prezantimi i Kurrikulës së re të nivelit 2 në KSHK, në Bujqësi organizuar nga projekti italian “*PEMA*”.
- Pjesëmarrje në ëorkshop-in me temë “*Nevoja për profesione dhe aftësi të reja profesionale në sektorin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme*”, mbështetur nga Projekti S4J.
- Pjesëmarrje në Konferencën “*Aftësitë e të ardhmes dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës*” organizuar nga AKAFPK, me porosi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe falë mbështetjes financiare të programit Erasmus+ të Komisionit Evropian, në mbështetje të projektit “*National Coordinators for Implementing the EU Agenda*”, së bashku me Risi Albania.

III.II Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të AFP-së

III.II.I Veprimtaria dhe kontributet e Sektorit të HKMM

Në zbatim të funksioneve dhe në plotësim të detyrave, Sektori i HKMM, gjatë vitit 2022, ka kontribuar nëpërmjet kryerjes së një tërësie procesesh dhe realizimit të disa produkteve kryesore që kanë mbështetur zhvillimin e AFP si në nivel qendror, ashtu edhe në nivelin e ofruesve publikë të AFP. Më poshtë renditen kontributet kryesore të këtij sektori, të ndara sipas fushave të veprimtarisë.

a) Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit kurrikular për AFP dhe mbështetja e zbatimit të tij

Përgatitja e dokumentacionit kurrikular (skeletkurrikula, programe kursesh të unifikuara, materiale mësimore mbështetëse, programe lëndore, module profesionale, programe shkollore të periudhës para vitit 2008, dokumentacion transferimesh të nxënësve) përbën vëllimin më të madh të punës së sektorit të HKMM edhe gjatë vitit 2022. Moderimi i hartimit të dokumentacionit të ri kurrikular është bërë në përputhje me metodologjinë dhe formatet e miratuara dhe në zbatim të Udhëzimit të MFE, nr. 27, datë 30.07.2018, “Për formatet dhe procedurat kurrikulare të AFP”. Përcaktimi dhe përgatitja e dokumenteve kurrikulare janë mbështetur në analizat e kryera dhe informacionet e marra nga zbatuesit e tyre, si dhe në dokumentet përkatëse të përgatitura nga Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale (lista e profesioneve, standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve). Garanci për cilësinë e këtyre produkteve ka qenë angazhimi i drejtpërdrejtë dhe përvoja e shumë bashkëpunëtorëve dhe grupeve të punës me specialistë të AFP, si dhe të biznesit, të përzgjedhur me kujdes nëpërmjet procedurave zyrtare të AKAFPK.



Bazuar në të dhënat e mbledhura për gjendjen e kurrikulave, si dhe në ndryshimet e standardeve të kualifikimeve përkatëse, gjatë vitit 2022, Sektori i HKMM ka koordinuar dhe moderuar procesin e hartimit të 3 skeletkurrikulave të reja të kualifikimeve profesionale si dhe rishikimit e përmirësimit të 20 skeletkurrikulave (për vitet shkollore 2022-2023 dhe 2023-2024). Gjithashtu, është rishikuar 1 program i lëndës profesionale “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12, si dhe janë hartuar 2 module profesionale, “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm”, kl. 12 dhe kl. 13. Përsa i përket programeve të kurseve të formimit profesional, u moderua hartimi i 10 programeve për Kurset e Unifikuara të FP, bazuar edhe në përshkrimet apo standardet e profesioneve përkatëse.

Për të mbështetur mësuesit e lëndëve profesionale dhe nxënësit në AP, duke konsideruar që në AP ka mungesa të theksuara të teksteve mësimore, Sektori i HKMM ka analizuar gjendjen, ka përcaktuar nevojat më prioritare dhe ka moderuar procesin e hartimit të 25 materialeve mësimore mbështetëse të lëndëve profesionale të AP. Në zbatim të Urdhërit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me nr. 115, datë 18.05.2020, “Për trajtimin e kërkesave të personave për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë para vitit shkollor 2008-2009”, Sektori i HKMM gjatë vitit 2022 ka gjeneruar programet sintetike të zbatuara në shkollat profesionale para vitit 2008 dhe ka plotësuar kërkesat për 85 aplikues, për programe të tilla. Gjatë vitit 2022, Sektori i HKMM ka kryer edhe procedurat e duhura për transferimin e 5 nxënësve, nga shkollat profesionale jashtë vendit, në shkollat profesionale të vendit tonë.

b) Monitorime për zbatimin e kurrikulave qendrore dhe për ecurinë e funksionimit të Njërive të Zhvillimit në ofruesit e AFP

Specialistët e Sektorit të HKMM kanë mbikëqyrur dhe kanë marrë informacione për ecurinë e zbatimit të Skeletkurrikulave të AP dhe Programeve të Kurseve të Unifikuara të FP, si dhe nevojave për materiale mësimore, nëpërmjet vizitave, takimeve të drejtpërdrejta dhe takimeve online me drejtues, mësues dhe instruktorë në shumicën e shkollave profesionale dhe DRFPP-ve të vendit.

- Janë kryer vizita monitoruese dhe mbledhje informacioni mbi ecurinë e zbatimit të Skeletkurrikulave të AP në 27 shkolla profesionale të Tiranës, Rubikut, Peshkopisë, Kukësit, Lezhës, Durrësit, Golemit, Kavajës, Elbasanit, Cërrikut, Korçës, Lushnjës, Beratit, Fierit, Vlorës, Sarandës dhe Gjirokastrës.
- Janë kryer vizita monitoruese dhe mbledhje informacioni mbi ecurinë e zbatimit të Programeve të Kurseve të Unifikuara të FP në 6 DRFPP të Durrësit, Elbasanit, Korçës, Fierit, Vlorës dhe Gjirokastrës.

Gjatë vizitave dhe takimeve të drejtpërdrejta janë shkëmbyer informacione me vlerë për aspektet kurrikulare si dhe janë dhënë sqarime dhe udhëzime për drejtuesit, koordinatorët e kurrikulave dhe mësuesit.



III.II.II Veprimtaria dhe kontributet e Sektorit të ZHVP

Sektori i ZHVP gjatë vitit 2022, në zbatim edhe të Udhëzimit të MFE nr. 21, datë 27.06.2022 për “Kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP”, e ka fokusuar veprimtarinë në tre drejtime kryesore:

a) Formimi fillestar i mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit publikë të AFP

Gjatë vitit 2022, Sektori i ZHVP ka koordinuar dhe harmonizuar zbatimin e Kursit të trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP”, për të gjithë mësimdhënësit fillestarë të kulturës profesionale, të emëruar (me kontratë të përkohshme) në ofruesit e AP, gjatë vitit shkollor 2021-2022. U konceptuan procedurat dhe u krijua baza elektronike e të dhënave që lidhet me gjithë procedurën e ofrimit të këtij kursi trajnimi. Kursi i trajnimit u realizua kryesisht në formatin me prezencë fizike në mjediset e Shkollës “Ekonomike” të Tiranës, dhe një pjesë në formatin online. Në kurs u angazhuan 14 trajnerë me përvojë, në të morën pjesë dhe u certifikuan me sukses 34 mësimdhënës nga ofrues publik të AP të Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Fierit, Shkodrës, Lushnjës, Vlorës dhe Korçës.

Sektori i ZHPO ka kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- Përgatitja e dokumentacionit zyrtar të ofrimit të kursit të trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP”, për vitin 2022 (shkresa të ndryshme, urdhëra, njoftime për pjesëmarrësit dhe bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve etj.).
- Krijimi i regjistrit elektronik me të dhënat e mësimdhënësve potencialë për ndjekjen e kursit të trajnimit.
- Përgatitja e materialeve të trajnimit të mësimdhënësve mbi “Bazat e didaktikës në AFP” (agjendat modulet, materialet mbështetëse, detyrat, materialet për vlerësimin, listë prezencat, certifikatat etj.).
- Koordinimi i trajnerëve dhe harmonizimi i programit të kursit 30 ditor për “Bazat e didaktikës në AFP”.

Është për t’u theksuar që ky funksion u realizua për herë të parë nga Drejtoria e ZHPO dhe shërben si një përvojë me vlerë për ecurinë e mëtejshme në vitet e ardhëshme.

b) Kualifikimi i vazhduar (atestimi) i mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit publikë të AFP

Gjatë vitit 2022, Sektori i ZHVP u angazhua për të administruar procedurën e Kualifikimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit publikë të AFP (të cilat më parë janë kryer nga institucionet e MAS). Në këtë proces morën pjesë 64 mësimdhënës nga ofrues publik të AFP, 7 prej të cilëve nuk u kualifikuan për mosplotësim të portofolit me dokumentacionin e kërkuar, brenda afateve të caktuara. Në përfundim të procesit të kualifikimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve, u certifikuan 56 prej tyre, sipas kategorisë përkatëse të

kualifikimit dhe 1 mësimdhënës nuk u kualifikua, pasi nuk u paraqit në provimin e kualifikimit. Lidhur me këtë proces janë kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- Moderimi i procesit të hartimit të standardit të profesionit “Mësimdhënës i kulturës profesionale në AFP”.
- Moderimi i procesit të hartimit të dy programeve të kualifikimit për dy grupe të mësimdhënësve, grupi “A” dhe grupi “B”, për vitin 2022.
- Krijimi i Komisionit të Kualifikimit të Mësimdhënësve të AFP-së.
- Përgatitja e dokumentacionit zyrtar të duhur për zbatimin e procedurës së kualifikimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në ofruesit e AFP, për vitin 2022 (udhëzuesa, urdhëra, shkresa të ndryshme, njoftime për bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve etj.).
- Krijimi i regjistrit elektronik me të dhënat e mësimdhënësve kandidatë për kualifikim, sipas kategorive të kualifikimit.
- Pranimi, shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar, vlerësimi paraprak me pikë, pranimi i ankimimeve, vlerësimi përfundimtar i 57 protofoleve dhe njoftimi për pikët e fituara i mësimdhënësve kandidatë.
- Mbikëqyrja e procesit të hartimit të njësive të testit për dy provimet e kualifikimit (sipas grupeve “A” dhe “B”) të mësimdhënësve.
- Organizimi, monitorimi dhe administrimi i procesit të provimeve të kualifikimit të dy grupeve, “A” dhe “B”.
- Vlerësimi me pikë i rezultateve të testeve të provimit të kualifikimit, pranimi dhe shqyrtimi i ankesave, njoftimi për rezultatet/pikët përfundimtare të fituara në provimet e kualifikimit.
- Llogaritja e rezultatit të kualifikimit të arritur (portofol dhe provim), pranimi, shqyrtimi i ankesave dhe njoftimi i kandidatëve për rezultatet/pikët përfundimtare të kualifikimit dhe shkallën e fituar.
- Konceptimi, printimi dhe dërgimi i certifikatave për 56 mësimdhënësit që kaluan me sukses këtë proces kualifikimi, në përputhje me kategorinë e kualifikimit përkatës.

Tashmë Sektori i ZHVP ka krijuar një paketë dokumentesh, një databazë elektronike të dhënash, një rrjet bashkëpunëtorësh dhe përvojë pozitive, si bazë për vijimin me sukses të këtij funksioni edhe në të ardhmen.

c) Mbështetja e Njësive të Zhvillimit të ofruesve publikë të AFP

Gjatë vitit 2022, Sektori i ZHVP ka trajnuar, udhëzuar e këshilluar koordinatorët e Njësive të Zhvillimit (NjZh), si dhe drejtuesit e ofruesve të AFP-së, në lidhje me përmbushjen e rolit që kanë. Kjo mbështetje është kryer si nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta (gjatë takimeve në AKAFPK dhe vizitave në 27 shkolla profesionale dhe 6 DRFPP), ashtu edhe nëpërmjet



veprimtarive të veçanta e komunikimeve në distancë (e-mail, biseda telefonike, webinarë). Sektori përgatiti një raport për monitorimin e realizuar në Njësitë e Zhvillimit.

Përsa i përket mbështetjes së mësimdhënësve të AFP për aspektet didaktike, Sektori i ZHVP, në takimet, bashkëbisedimet dhe vëzhgimet e kryera në shkollat profesionale dhe DRFPP-të, ka marrë të dhëna për gjendjen dhe nevojat e mësimdhënësve dhe ka ofruar mbështetjen për ta.

Përfaqësues nga Drejtoria e ZHPO janë angazhuar edhe në hartimin e programeve të trajnimit dhe si trajnerë në moderimin e seancave të trajnimit (me prezencë fizike dhe online), si më poshtë:

- Trajnimi për “Bazat e didaktikës në AFP”, për rreth 70 mësimdhënës të Tiranës dhe Durrësit (mbështetur nga GIZ).
- Trajnimi 6 ditor për 15 Koordinatorë të Marrëdhënieve me Biznesin (mbështetur nga OeAD).
- Trajnimi 3 ditor për rreth 40 Koordinatorë të Sigurimit të Cilësisë (mbështetur nga OeAD).
- Trajnimi i 20 mësuesve të shkollave bujqësore (mbështetur nga PEMA).

Në kuadër të fillimit të vitit shkollor 2022-2023, Drejtoria e ZHPO kontribuoi në përgatitjen dhe publikimin e një *“Udhëzuesi për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale”* me informacione mjaft të dobishme për aspektet kurrikulare, të mësimdhënies, të vlerësimit të nxënësve, të organizimit të orarit të shkollave, të orientimit të tyre nga kërkesat e tregut rajonal të punës etj.

III.II.III Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimeve

Një pjesë e ndjeshme e kohës së punës së Drejtorisë së ZHPO i është kushtuar veprimtarive të ndryshme në kuadrin e porosive të Ministrisë përgjegjëse për AFP (MFE) dhe të bashkëpunimeve të kryera me institucione kombëtare dhe aktorë të tjerë, me projektet e donatorëve dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare që janë partnerë të rëndësishëm në zhvillimin e AFP në Shqipëri. Të tilla veprimtari janë:

- Pjesëmarrje në grupin e punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030.
- Pjesëmarrje në procesin e rishikimit të kuadrit ligjor të AFP, hartimit të draft-eve të akteve nënligjore të AFP (kryesisht për Udhëzimin e MFE, nr. 21, datë 27.06.2022, “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP”).
- Pjesëmarrje në Komitetin e Maturës Shtetërore, komente për aktet nënligjore të lidhura me Maturën Shtetërore Profesionale (udhëzimet dhe rregulloret).
- Pjesëmarrje në takime për diskutimin, si dhe komentimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorisë apo të njësisë të tjera të AKAFPK, në kuadrin e bashkëpunimit të brendshëm të AKAFPK.
- Pjesëmarrje në Komisionin e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve, anëtarë të grupeve të punës, për produktet e AKAFPK.



- Pjesëmarrje në Komisionin e Kualifikimit të Mësimdhënësve të AFP.
- Pjesëmarrje në Sekretariatit e Këshillit Kombëtar të AFP.
- Pjesëmarrje në Komisionin e transferimit të nxënësve në AP.
- Pjesëmarrje në takimet e Sekretariatit Teknik të Komiteteve Sektoriale.
- Përgatitja e planit të buxhetit të Drejtorisë së ZHPO, si dhe ndryshimet eventuale gjatë vitit.
- Komente dhe plotësime në Rregulloren dhe Udhëzimin për Maturën Shtetërore Profesionale, 2022-2023 dhe 2023-2024.
- Komente për Urdhrin për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 (kërkesë nga MAS).
- Takime në MFE për aspekte të ndryshme të AFP.
- Takime, diskutime dhe konsultime të vazhdueshme, si dhe pjesëmarrje aktive në veprimtaritë e EPALE.
- Pjesëmarrje aktive në webinar-et e EPALE.
- Pjesëmarrje në Programin Rajonal (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut) “*Shkolla takon Biznesin*”, mbështetur nga OeAD.
- Pjesëmarrje dhe prezantime në Takimet dhe Trajnimet për “*Shkolla takon Biznesin*”, organizuar në Tiranë ose online (OeAD).
- Pjesëmarrje dhe prezantime në Takimet dhe Trajnimet për Koordinatorët e Sigurimit të Cilësisë (OeAD).
- Takime dhe kontribute në kuadrin e veprimtarive të projektit S4J për materialet mësimore digjitale dhe aspekte të tjera.
- Takime dhe kontribute në kuadrin e veprimtarive të projektit PEMA për shkollat bujqësore.
- Takime dhe shkëmbime informacioni me konsulentët e Programit për mbështetjen e zbatimit të kualifikimit “*Shërbime mekatronike në automjete*” (GIZ-PROSEED).
- Pjesëmarrje në takimet dhe webinar-et online për aspekte të ndryshme të AFP, organizuar nga S4J, OEAD, GIZ, PEMA, EPALE, ETF, UNDP, SREPVET etj.

III.II.IV Veprimtari të tjera.

Drejtoria e ZHPO, gjatë vitit 2022 ka kryer edhe veprimtari të tjera që lidhen me:

- Përgatitjen e dokumentacionit zyrtar që ka të bëjë me veprimtarinë dhe produktet (raporte javore, periodike dhe vjetore, plane periodike dhe vjetore, listë-prezenca të stafit, shkresa të ndryshme, njoftime për bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve, planifikimi i buxhetit të drejtorisë, dokumentacioni financiar, vlerësimi i stafit, materialet për publikime në faqe interneti etj.).
- Kontribute në rifreskimin me informacione të faqes së internetit të AKAFPK.



- Trajnimin dhe vet-trajnimin e vazhdueshëm të stafit. Kjo është kryer nëpërmjet studimit individual, shkëmbimit të përvojës, pjesëmarrjes në veprimtari trajnimit të drejtpërdrejta ose online, kryesisht të ofruara nga ASPA dhe donatorët, ndjekjes së kualifikimeve formale etj.

III.III Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së

Përgjatë vitit 2022, Sektori i Akreditimit të ofruesve të AFP-së, për realizimin e veprimtarive të planifikuara në fushën e Sigurimit të Cilësisë, është mbështetur në objektivat vjetore të kësaj njësie organizative, si dhe në objektivat specifike për çdo punonjës të tij. Puna e këtij Sektori është fokusuar në dy drejtime kryesore:

- I.** Procesi i vetëvlerësimit të IoAFP-ve
- II.** Pilotimi i Procesit të Akreditimit

III.III.I Zhvillimi i Procesit të vetëvlerësimit të IoAFP-ve

a) Mbështetja dhe monitorimi i IoAFP-ve për realizimin e procesit të vetëvlerësimit

Në kuadër të bashkëpunimit me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” dhe me mbështetjen e MFE, gjatë këtij viti i gjithë procesi i vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së, u zhvillua sipas një kalendari të miratuar nga AKAFPK-ja, për të gjitha hapat e procesit dhe u realizua mbështetja e ofruesve në trajnimin e përdorimit të platformës elektronike të vetëvlerësimit, si dhe finalizimi i procesit të vetëvlerësimit për 44 institucione publike dhe 1 ofrues jo publik.

Ky proces u finalizua me dorëzimin e raporteve finale të vetëvlerësimit nga të gjithë ofruesit e AFP-së, 44 institucione publike dhe 1 ofrues jo publik, përfshirë kontrollin e "gatishmërisë për akreditim".

Në kuadër të procesit të vetëvlerësimit, si një proces i rëndësishëm në zhvillimin e brendshëm të cilësisë në institucionet ofruese të AFP-së dhe diseminimit e komunikimit me grupet e interesit për nisjen e procesit të akreditimit, u organizuan pesë takime rajonale në qytetet Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë. Në këto takime rajonale u diskutua në lidhje me ecurinë e procesit të vetëvlerësimit si dhe informimi për hapat dhe procedurat e mëtejshme të nisjes së procesit të akreditimit.

Në vijim, gjatë vitit shkollor 2022-2023 procesi i vetëvlerësimit u realizua për vitin shkollor 2021-2022, mbështetur në udhëzimin nr. 18, datë 06.07.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 08.05.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”, ku të gjithë IoAFP-të do të vlerësojnë pesë fushat e cilësisë. Për këtë, është hartuar dhe shpërndarë kalendari i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit në institucionet ofruese të AFP-së, duke ndryshuar afatet e zhvillimit të procesit të vetëvlerësimit, për



ti shërbyer procesit të akreditimit, si hapi i parë i këtij procesi kaq të rëndësishëm të sigurimit të cilësisë, e duke e finalizuar këtë proces më datë 31 janar 2023.

Gjatë muajit dhjetor 2022, në bazë të një plani të miratuar të monitorimit dhe mbështetjes së procesit të vetëvlerësimit, duke respektuar afatet e Kalendarit të zhvillimit të procesit të vetëvlerësimit, u vizituan të gjithë institucionet ofruese të AFP-së, pasi u ishte dërguar më parë edhe një dokument i ri në shërbim të procesit, *“Instrumenti për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë”*. Gjatë takimeve individuale në çdo IoAFP u diskutua dhe asistua përdorimi i platformës digjitale *scvet.al* dhe implementimi i instrumentit të përmirësimit të cilësisë, i cili duhet përfshirë në raportin përfundimtar të vetëvlerësimit.

b) Analiza e raporteve individuale të IoAFP-ve dhe përgatitja e raportit përmbledhës të rezultateve të vetëvlerësimit në nivel kombëtar 2020-2021

Mbështetur në Udhëzimin nr. 18, datë 06.07.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *“Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 08.05.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”*, ofruesit publikë të AFP-së kanë zbatuar procesin e vetëvlerësimit sipas një kalendari të miratuar nga AKAFPK, kanë mbledhur të dhënat dhe kanë hartuar raportin përfundimtar të vetëvlerësimit.

Në përfundim të procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2020-2021, u mblodhën të gjitha raportet e dërguara nga ofruesit e AFP-së, të cilat u analizuan nga sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së, gjatë periudhës qershor-dhjetor 2022, për të përgatitur raportin përmbledhës për rezultatet e vetëvlerësimit në nivel kombëtar.

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2020-2021 tashmë ishte në vitin e katërt, i cili dëshmoi për një rritje të ndërgjegjësimit të ofruesve të AFP-së, për rolin e procesit të vetëvlerësimit në sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit në 44 institucione ofruese publike të AFP-së, ka evidentuar aspektet pozitive dhe ato problematike, në pesë fushat e cilësisë dhe rezultatet e procesit të vetëvlerësimit janë mbajtur në konsideratë për hartimin e raportit kombëtar të vetëvlerësimit.

Në vijim, duhet të punohet më tepër në ndërgjegjësimin e IoAFP-ve për rolin e procesit të vetëvlerësimit në sigurimin e brendshëm të cilësisë, përvetësimin e mëtejshëm të instrumentit dhe rritjen e efikasitetit të administrimit në tërësi të procesit të Vetëvlerësimit.

III.III.II Pilotimi i Procesit të Akreditimit

a) Faza fillestare

AKAFPK-ja, në bashkëpunim me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” ka zhvilluar për herë të parë tashmë, me një ekspertizë ndërkombëtare, një model të plotë të procesit të Akreditimit, për Institucionet ofruese të AFP-së. Në mbështetje të Urdhrit nr. 128, datë 06.07.2021 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional” të MFE-së, janë zhvilluar veprimtari dhe dokumente të tjera si:

- Hartimi i procedurave, dokumenteve dhe formularëve të standardizuar në mbështetje të procesit të akreditimit.
- Hartimi dhe përshtatja e pyetësorëve për nxënësit, mësimdhënësit, bizneset, prindërit.
- Instrumenti i analizës së pyetësorëve.
- Hartimi i procesverbaleve për dokumentimin e proceseve të akreditimit.
- Hartimi i matricës për zbatimin e procedurës të akreditimit.
- Përgatitja e një modeli të regjistrit kombëtar të certifikatave të akreditimit.

Mbështetur edhe në modelet e ofruara nga eksperti ndërkombëtar, u finalizua hartimi i Aneksit 1 “Për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm në procesin e akreditimit të ofruesve të AFP”. Pas një pune voluminoze të realizimit të modelit të parë të procesit të akreditimit, me standardet, procedurat, instrumentet dhe udhëzimet e zbatimit të procesit, nisi zbatimi i procesit të akreditimit.

Bazuar në Urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional” të MFE-së, u realizua pilotimi i procesit të akreditimit, bazuar në gatishmërinë e ofruesit për akreditim, ku u përfshinë pesë institucione publike dhe një ofrues jo publik i arsimit profesional, duke përzgjedhur kualifikime profesionale nga oferta e tyre arsimore.

Institucionet e përfshira në këtë proces dhe numri i kualifikimeve përkatëse janë si më poshtë:

- 1) Shkolla e Mesme Profesionale, Kamëz ⇒ 4 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
- 2) Shkolla e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, Durrës ⇒ 5 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
- 3) Shkolla e Mesme Teknike Elektrike “Gjergj Canco”, Tiranë ⇒ 13 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
- 4) Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela”, Durrës ⇒ 14 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
- 5) Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike, Tiranë ⇒ 10 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.
- 6) Qendër Multifunksionale “New Generation”, Tiranë ⇒ 4 kualifikime profesionale sipas KSHK-së.



Grupet e vlerësuesve të jashtëm për çdo IoAFP, mbështetur edhe nga koordinatorët e këtij procesi, arritën të finalizojnë dhe të dorëzojnë raportet përfundimtare të Akreditimit, të cilat ju përcollën në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas procedurës së miratuar.

b) Zhvillimi i mëtejshëm i burimeve njerëzore për vlerësuesit e jashtëm të procesit të akreditimit

AKAFPK, në vijim të zhvillimit të mëtejshëm të burimeve njerëzore, ka përzgjedhur një listë me specialistë të fushës, për t'u trajnuar dhe certifikuar si vlerësues të jashtëm në procesin e akreditimit të ofruesve të AFP-së. Këtë proces kaq të rëndësishëm, në zbatim të planit për ngritjen e kapaciteteve të vlerësuesve të jashtëm e udhëhoqi Z. Serban Iosifescu - konsulent i UNDP Albania.

Ky proces u fokusua më së shumti në rekrutimin, përzgjedhjen dhe trajnimin e vlerësuesve të jashtëm dhe trajnimin e ekspertëve të brendshëm të AKAFPK-së. Programi i trajnimit u zhvillua për grupin e dytë, ku u pajisën me certifikatë 19 vlerësues të jashtëm për akreditimin e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional, i cili u zhvillua gjatë periudhës dhjetor 2021 - shkurt 2022, në total 10 ditë/60 orë trajnimi (36 orë teori dhe 24 orë praktikë). Gjithashtu, vijon procesi i trajnimit të grupit të tretë, me 14 kandidatë të tjerë për vlerësues të jashtëm të IoAFP-ve. Ky grup ka përfunduar vetëm bllokun e parë të trajnimit (pjesa teorike) gjatë 2022 dhe me certifikimin e tij, në total janë 50 kandidatë si vlerësues të jashtëm të procesit të akreditimit dhe 4 specialistë të AKAFPK-së.

Gjithashtu, u organizua trajnimi i vazhduar profesional ku pjesëmarrës ishin 33 vlerësues të jashtëm të certifikuar (nga grupi i I-rë dhe grupi i II-të), për zbatimin e procesit të akreditimit për IoAFP-të, me fokus reagime dhe ndarje përvojash nga vlerësuesit e jashtëm të përfshirë në proces pilotimi të Akreditimit të IoAFP-ve.

Trajnimi i organizuar në seancat reflektuese me vlerësuesit e jashtëm dhe me stafin e AKAFPK-së, synoi të identifikojë dhe të gjejë zgjidhje për sfidat, pengesat, vështirësitë, çështjet e shqetësimet e hasura gjatë pilotimit të procesit të Akreditimit të IoAFP-ve. Pjesëmarrësit bënë një analizë të detajuar duke filluar nga vizita në terren, komunikimi me ofruesit e AFP-së, aksesit në dokumentacionin e ofruesit, përdorimi i instrumenteve të vlerësimit, interpretimi i evidencave, hartimi i raportit përfundimtar, finalizimi i raportit përfundimtar të Akreditimit me instrumentet shoqëruese (përfshirë përshkruesit e nivelit), duke arritur në përfundimin e domosdoshmërisë për të ndryshuar urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021 “Për miratimin e “Rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”.

III.III.III Informim në lidhje me procesin e akreditimit

a) Takime rajonale



Në kuadër të procesit të diseminimit e komunikimit me grupet e interesit për nisjen e procesit të akreditimit, u organizuan pesë takime rajonale, me pjesëmarrjen e 44 IoAFP-ve, në qytetet Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë. Në këto takime rajonale u diskutua në lidhje me ecurinë dhe rëndësinë e procesit të vetëvlerësimit si dhe informimi për hapat dhe procedurat e mëtejshme të nisjes së procesit të akreditimit.

b) Marketing dhe komunikim me grupet e interesit për procesin e akreditimit

Me fokus promovimin dhe komunikimin me grupet e interesit për procesin e akreditimit, u zhvillua një video promovuese, në bashkëpunim me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim”.

c) Monitorimi i IoAFP-ve në të cilat është pilotuar procesi i akreditimit

Monitorimi i IoAFP-ve nuk ka nisur ende, pasi është duke u zhvilluar një model i konceptit të Planit të monitorimit për secilin tip monitorimi dhe metodologjia përkatëse e zbatimit të tij, ndërkohë jemi në pritje të vendimit të akreditimit për çdo IoAFP, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

III.III.IV Veprimtari në kuadër të bashkëpunimeve

a) Në kuadër të bashkëpunimit me MFE, janë kryer këto veprimtari:

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Punësimin dhe Aftësimin Profesional, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u përgatit draft-i i Udhëzimit për “*Organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2022 dhe për Rregulloren e Maturës Shtetërore 2022*”.
- Pjesëmarrje në grupin e inspektimit për licencimin e ofruesve privat të AFP-së.
- Komentë për Projektligjin “*Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*”, i ndryshuar.

b) Veprimtari në kuadër të projektit të Kulturë-Kontakt:

- Pjesëmarrje dhe moderim në takime me fokus përgatitjen e programit të trajnimit për “*Koordinatorët e Sigurimit të Cilësisë (përgjegjësit e Njësive të Zhvillimit) të IoAFP-ve publike*”.
- Kontribut në zhvillimin e mëtejshëm të instrumentit për “*Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë*” si dhe përdorimi i rezultateve nga identifikimi i problemeve”.

c) Përgatitja e termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm:

- Ndjekja e procedurave për njoftimet për bashkëpunëtorë, për ngritjen e grupeve të vlerësuesve të jashtëm, në kuadër të procesit të akreditimit të IoAFP-ve.



- Përgatitja e kontratave të shërbimit, për bashkëpunëtorët e Sektorit të akreditimit të ofruesve të IoAFP-ve që shpallen fitues.
- Përgatitja e urdhër-pagesave dhe ndjekja e procedurave për pagesën e bashkëpunëtorëve.

III.III.V Të tjera

- Përcaktimi i objektivave të vitit.
- Hartimi i planeve mujore të detajuara dhe raportimi i tyre.
- Hartimi i planit vjetor dhe raportimi i tij.
- Kontribut në hartimin e rregullores së AKAFPK-së.
- Kontribut në dizenjimin e faqes së re të web-it të AKAFPK-së.
- Pjesëmarrje në komisione apo takime të ndryshme.

III.IV Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve

AKAFPK është krijuar si institucion në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 24.11.2020 “Për Miratimin e Strukturës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”. Në zbatim të dokumentit zyrtar të Departamentit të Administratës Publike me nr. prot. 2713/1, datë 27.04.2021, me lëndë “Mbi procesin e ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, AKAFPK u riorganizua.

Me ristrukturimin e institucionit, u krijua Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve, i cili gjatë këtij viti ka punuar në mungesë të Përgjegjës të sektorit. Ky sektor ka punuar në vështirësi duke përballuar volumin e punës së aktiviteteve institucionale në mungesë të anëtarëve të stafit përbërës të tij.

Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve mbulon detyra mbështetëse në administrimin e burimeve njerëzore dhe financiare, zbatimin e normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, mirë administrimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të institucionit, sistemin kompjuterik, teknologjinë e informacionit si dhe aplikimin e pjesëmarrjen në zbatimin e projekteve.

Zbatimi i ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar për shërbimin civil ka vazhduar të jetë në qendër të vëmendjes së AKAFPK-së. Departamenti i Administratës Publike (DAP), si institucioni publik, qendror, përgjegjës për menaxhimin, mbikëqyrjen e shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore ka bashkëpunuar me AKAFPK në procesin e plotësimit të vendeve vakante në strukturën e re të saj.

Janë shpallur pozicionet e reja vakante në përputhje me Strukturën e re të AKAFPK. Si rrjedhojë e konkurrimit për pozicionet vakante të AKAFPK-së në lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë apo konkurrim nga jashtë shërbimit civil janë plotësuar 7 pozicione, nga të cilat: 1 drejtor drejtorie, 2 përgjegjës sektori si dhe 4 specialistë.

Sektori ka zbatuar me përpikmëri udhëzime e marra nga DAP apo ka ndjekur trajnimet online në ndihmë të konsolidimit dhe mirëfunksionimit të regjistrimit elektronik HRMIS (Human Resources Management Information System), sistemin e menaxhimit të regjistrimit të punonjësve të Administratës Publike. Në përputhje me udhëzimet periodike të DAP-it, nëpunësi i AKAFPK-së, që merret me burimet njerëzore ka vazhduar punën me plotësimin e regjistrimit HRMIS me të dhënat kryesore të punonjësve të AKAFPK-së. Gjenerimi i pagave në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ/HRMIS) është realizuar çdo muaj të vitit 2022 nga nëpunësi zbatues i AKAFPK-së.

AKAFPK përfaqësohet nga faqja elektronike zyrtare me adresë: www.akafp.gov.al. Kjo faqe është aktive dhe përditësohet me veprimtari e njoftime të ndryshimit për t'i ardhur në ndihmë bashkëpunëtorëve shqiptarë apo të huaj, të interesuar në realizimin e produkteve në fushën e AFP-së. Në rritje të transparencës, është publikuar, gjithashtu, mënyra e funksionimit të institucionit, mënyra e financimit të tij, e organizimit, struktura, adresa e institucionit, numrat e kontaktit si dhe adresa elektronike. Gjithashtu, në këtë faqe elektronike pasqyrohen veprimtaritë e projekteve të AKAFPK-së në kuadër të Programit “ERASMUS + (ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA, ERASMUS-EDU-2022-EPALE-IBA dhe ERASMUS-EDU-2022-CB-VET). Sektori, veç rolit kryesor në përditësimin e web-it të AKAFPK-së, ka administruar dhe mirëmbajtur rrjetin kompjuterik të institucionit.

Në kuadër të përmirësimit të komunikimit të brendshëm në platformën elektronike “Whatsapp”, rekomanduar nga MFE, për të lehtësuar shpërndarjen e informacionit në kohë reale për të gjithë punonjësit e MFE dhe të institucioneve të saj të varësisë, AKAFPK nëpërmjet grupit të punonjësve të saj, ka shkëmbyer informacione në shërbim të objektivave institucionale duke evidentuar aktivitetet më të rëndësishme.

Në mbështetje të pikës e) të nenit 24 dhe pikës a) të nenit 43, të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” janë dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, dokumentet arkivorë me afat ruajtje përgjithmonë (RHK) të viteve 2007 dhe 2008, të AKAFPK-së, që kalojnë për ruajtje dhe administrim në Arkivin Qendror Shtetëror.

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, si dhe të dokumentit zyrtar të Departamentit të Administratës Publike me nr. prot. 1359/7, datë 15.03.2022 me lëndë “Emërim” drejtuar Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, është emëruar një nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e specialistit pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve, i cili ka marrë detyrën e arkiv/protokollit të AKAFPK-së. Lidhur me sa më sipër janë protokolluar dokumentet e vitit 2022 si edhe janë realizuar regjistrimet elektronike të tyre në funksion të mirë menaxhimit të dokumentit zyrtar të AKAFPK-së.

Krahas punës periodike në administrimin e dokumentacionit zyrtar elektronik e fizik të AKAFPK-së, në përputhje me procedurat administrative të institucionit si edhe legjislacionit aktual, sektori ka kontribuar në hartimin e programit të transparencës së AKAFPK-së si edhe në rifreskimin e vazhdueshëm të tij. Programi i transparencës përcakton kornizën e veprimtarisë së Agjencisë në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe është i pasqyruar në faqen zyrtare elektronike të AKAFPK-së, në adresën: <http://www.akafp.gov.al/rreth-nesh/programi>.

AKAFPK, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 09.07.2015 “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në gjimnaz”, në zbatim të Rregullores së brendshme të AKAFPK-së “Për procedurat e transferimit të nxënësve shqiptarë ose të huaj, të cilët transferojnë studimet nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri - procedura e njëvlershmërisë së studimeve të kryera” ka ndihmuar në çështjet administrative lidhur me këtë proces. Në bashkëpunim me komisionin përkatës, sektori ka kontribuar në shqyrtimin e rasteve të paraqitura pranë AKAFPK-së në përputhje me legjislacionin në fuqi.

AKAFPK në bashkëpunim me MFE dhe SHKP ka inspektuar objektet shkollore mbi përmbushjen ose jo të standardeve normative nga ana e objektet shkollore, që aplikojnë për licencim pranë QKB-së. Lidhur me sa më lart, 1 përfaqësues i sektorit si pjesë e grupit të inspektimit ka kontribuar në inspektimin e 1 objekti shkollor dhe mbajtjes së akt-inspektimit në këtë subjekt.

AKAFPK-ja është njësia koordinuese dhe përgjegjëse për zbatimin e Platformës Evropiane për Arsimin e të Rriturve (EPALE). Në kuadër të kësaj platforme AKAFPK ka zbatuar projektin EPALE NSS 2022-2024. Në këtë projekt, sektori ka dhënë kontributin e anëtarëve të tij në zbatim të objektivave të projektit dhe në përputhje me marrëveshjen e tij. Po kështu, sektori ka dhënë kontribut në dy projektet e tjera të AKAFPK-së si: ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA dhe ERASMUS-EDU-2022-CB-VET, në zbatimin e aktiviteteve të këtyre projekteve , si dhe në korrespondencat zyrtare midis Institucionit dhe MFE.

Me mbështetjen e Programit IPA të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, po zbatohet projekti “Asistenca Teknike për të Mbështetur Reformën mbi Politikën e Punësimit, Arsimin dhe Formimin Profesional”. Ky projekt i BE, ofron mbështetje të institucioneve përgjegjëse për AFP-në në funksion të zbatimit të legjislacionit, si dhe zhvillimit të planifikimit dhe zbatimit të mekanizmave mbështetëse në fushën e AFP-së. AKAFPK, si institucion përgjegjës për AFP-në ka kontribuar në takime me ekspertët e BE si dhe ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të këtij projekti.



Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 24.11.2020 “Për Miratimin e Strukturës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, është punuar ngushtë me drejtorin e AKAFPK-së lidhur me rishikimin e përshkrimeve të punës për pozicionet e punës të krijuara nga riorganizimi i këtij institucioni dhe në përputhje me objektivat e institucionit të riformuar. Gjithashtu, në mbështetje të këtij riorganizimi është dhënë ndihmesë në përgatitjen e draft-rregullores së re, të brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKAFPK-së.

Për vitin buxhetor 2022, AKAFPK filloi aktivitetet e saj në janar 2022 me një buxhet të përgjithshëm prej **61,949,000 lekë**, të ndryshuar më pas në **54,771,832 lekë** të miratuar nga MFE për artikullin 600, 601, 602 dhe 606. AKAFPK për vitin 2022 ka realizuar aktivitetet e planifikuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MFE dhe të realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2022

KODI I PROJEKTIT	Artikulli	Plani i çelur	Plani i ndryshuar	Fakti
91011AD	600	10,007,000	9,146,200	9,146,117
91011AE	600	8,000,000	5,336,980	5,336,305
91011AF	600	5,067,000	2,944,000	2,943,919
91011AI	600	2,575,000	900,652	899,670
	SHUMA	25,649,000	18,327,832	18,326,011
91011AD	601	1,038,000	1,038,000	1,031,672
91011AE	601	900,000	900,000	899,201
91011AF	601	800,000	778,000	777,812
91011AI	601	412,000	338,000	337,741
	SHUMA	3,150,000	3,054,000	3,046,426
91011AD	602	12,300,000	12,300,000	8,450,487
91011AE	602	11,350,000	11,350,000	5,225,300
91011AF	602	6,500,000	6,500,000	1,417,733
91011AI	602	3,000,000	3,000,000	2,407,736
	SHUMA	33,150,000	33,150,000	17,501,256
91011AD	606		240,000	240,000
BUXHETI GJITHSEJ	SHUMA	61,949,000	54,771,832	39,113,693

Grafiku i shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MFE dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË




Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “EPALE National Support Services (NSS) for Albania” EPAL NSS 2022-24 në llogaritë Lek dhe Euro.

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2022	Çelur gjatë vitit 2022	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2022	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	5,161,791	17,902,673	23,064,464	3,335,141	19,729,323
Llogaria në Euro	7,000.70		7,000.70	2.5	6,998.20

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit ERASMUS-EDU-2021-AL-AGENDA-IBA në llogaritë Lek dhe Euro

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2022	Buxheti i çelur gjatë vitit 2022	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2022	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	235,666	1,298,716.00	1,534,382.00	588,501.02	945,880.98
Llogaria në Euro	520.70	-520.7	0.00	0	0



Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit FORWORK në llogaritë Lek dhe Euro

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2022	Çelur gjatë vitit 2022	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2022	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	3,572,332		3,572,332	3,572,331	0.00
Llogaria në Euro	0		0	0	

Sektorit ka bashkëpunuar me sektorët e AKAFPK-së dhe MFE për hartimin e Projekteve të Buxheteve Afatmesme dhe Afatgjata (PBA) të institucionit. Në mbështetje të Ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor 2020 - 2022” sektorët e AKAFPK kanë bashkëpunuar në përgatitjen e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si edhe në zbatim të udhëzimit nr.1, pika 7, datë 27.06.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”, Autoriteti Përgjegjës Teknik i AKAFPK-së (përgjegjësi i Sektorit të Kualifikimeve Profesionale në mungesë të Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve) për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike ka raportuar periodikisht pranë ILDKPKI dhe ka dorëzuar për titullarin e AKAFPK-së formularët e plotësuar të deklaratimit të interesave private të tyre. Gjithashtu, në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm dhe Sektorët e AKAFPK-së është përgatitur Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” për AKAFPK-në e cila është dorëzuar së bashku me raportin periodik vjetor pranë ILDKPKI-së.



ANEKS

Aneks 1: Produkte që lidhen me profesionet

a) Analizat e profesionit të përshtatura nga LKP për zhvillimin e kurseve afatshkurtra:

1. “Menaxhim hoteli”
2. “Operator turistik”
3. “Poligrafi”
4. “Shërbime në bletari”
5. “Punim xhami”
6. “Udhërrëfim turistik”
7. “Grafik dizajn”
8. “WEB dizajn”
9. “Riparim kompjuteri”
10. “Marketingu digjital”

b) Standarde Profesioni:

1. “Elektromekanik” 7412
2. “Punonjës për produkte brumi” 7513
3. “Punëtor pyjesh” 9215
4. “Ndihmës mekanik” 72
5. “Motorist” 7231.16
6. “Elektroaut për automjete” 7231.03
7. “Xhenerik” 7231.24
8. “Teknik në bujqësi” 6130
9. “Punëtor në bujqësi” 9211
10. Mobilier “Prodhues i mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm” 7522.06
11. “Betonues dhe hekurkthyes” 7114
12. “Ndërmjetës i pasurive të paluajtshme” 3334
13. “Hidraulik në ujësjellës kanalizime” 7126
14. “Punonjës ndihmës në shërbimet sociale dhe shëndetësore” 53
15. “Prodhues të produkteve dhe nënprodukteve të qumështit” 7515
16. “Fonditorë, saldatorë, punëtorë llamarine, përgatitës të konstruksioneve metalike, etj.” 721
17. “Punonjës të tekstileve, të lëkurës, veshjeve dhe të ngjashme me to” 753
18. “Punonjës të prodhimit të pijeve” 8160
19. “Punonjës për punime dhe riparime rrugësh” 7119.15
20. “Punonjës për prodhime druri gjysmë të gatshme” 7521
21. “Teknik hidraulik” 3112.09



Aneks 2: Standarde të Kualifikimeve Profesionale

1. R-IV-17-Gjeodezi
2. F-II-17-Mekanikë
3. E4-III-19-Elektromekanikë
4. G-II-17-Hoteleri-turizëm
5. S-II-22-Pyje
6. A5-III-18-Teknologji e përpunimit të brumërave
7. M1-III-18-Shërbime motori
8. M2-III-18-Shërbime xhenerike
9. M3-III-18-Shërbime elektro-auto
10. H-II-22-Bujqësi
11. L1-V-22-Ndërmjetësimi i pasurive të paluajtshme
12. B3-III-22-Karpentieri, hekurkthim dhe betonim
13. C1- III-22-Mobileri dhe tapiceri
14. V3-III-22-Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime
15. A3-III-17-Teknologjia e përpunimit të qumështit
16. O-II-22-Shërbime sociale dhe shëndetësore
17. H/1-IV-22 Agrobiznes (Bujqësi tradicionale dhe organike)
18. D-II-17-Tekstil-Konfeksione
19. B4-III-18-Punime dhe riparim rrugësh
20. G2-III-22-Kuzhine-Pastiçeri

Aneks 3: Programe Orientuese

a) Programe të reja orientuese të niveleve

- Niveli III:

1. Punime dekorative dhe bojatisje
2. Shërbime karrocerie

- Niveli IV:

1. Administrim zyre
2. Multimedia
3. Programim

- Niveli V

1. Dizenjim mode
2. Diagnostikim-menaxhim në autoservis

b) Programe të reja të maturës shtetërore profesionale

1. Administrim zyre



2. Multimedia
3. Programim

c) Programe orientuese të rishikuara të niveleve

- Niveli II

1. Shërbime mjetesh transporti
2. Termohidraulikë

-Niveli III

Shërbime kujdesi për të moshuar

- Niveli IV

1. Gjeodezi
2. Rrjete të dhënash
3. Mbështetje e përdoruesve të TIK
4. Zhvillim website
5. Shërbime sociale dhe shëndetësore

d) Programe të rishikuara të maturës shtetërore profesionale

1. Gjeodezi
2. Rrjete të dhënash
3. Mbështetje e përdoruesve të TIK
4. Zhvillim website
5. Shërbime sociale dhe shëndetësore

Aneks 4: Suplemente të Certifikatave dhe plane mësimore

a) Suplemente të Certifikatave:

i. Të reja:

-Niveli III

1. Punime dekorative dhe bojatisjen
2. Shërbime karrocierie

- Niveli IV

1. Telekumunikacion
2. Riparime të pajisjeve elektronike
3. Teknologji bujqësore

- Niveli V

1. Dizenjim mode
2. Diagnostikim-menaxhim në autoservis

ii. Të rishikuara:

- Niveli II



1. Bujqësi
2. Shërbime mjetesh transporti
3. Termohidraulikë
 - *Niveli III*
1. Shërbime kujdesi për të moshuar
 - *Niveli IV*
1. Gjeodezi
2. Bujqësi
3. Elektroteknikë
4. Llogari
5. Shërbime bankare
6. Sigurime
7. Sipërmarrje e agjencisë turistike
8. Tregti

b) Planet mësimore të kualifikimeve profesionale të reja dhe të rishikuara të ofruara në vitin shkollor 2022-2023

i) Të reja

1. Telekumunikacion
2. Riparime të pajisjeve elektronike
3. Teknologji bujqësore

ii) Të rishikuara

1. Gjeodezi
2. Bujqësi
3. Elektroteknikë
4. Llogari
5. Shërbime bankare
6. Sigurime
7. Sipërmarrje e agjencisë turistike
8. Tregti
9. Shërbime mjetesh transporti
10. Termohidraulikë
11. Shërbime sociale dhe shëndetësore
12. Ndërtim

Aneks 5: Skeletkurrikula të Arsimit Profesional

a) Të reja (3 skeletkurrikula):



- 1) Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Mekatronikë” (2 vjeçar), Niv. IV i KSHK, i drejtimit mësimor “Elektroteknikë”
- 2) Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Ujësjetës - kanalizime”, Niv. III i KSHK, i drejtimit mësimor “Termohidraulikë”
- 3) Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, Niv. V i KSHK, i drejtimit mësimor “Ekonomi - biznes”

b) Të rishikuara (20 skeletkurrikula):

1. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Muratim dhe suvatim”, Niv. III i KSHK
2. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Elektroteknikë”, Niv. II i KSHK
3. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, Niv. IV i KSHK
4. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Hoteleri turizëm”, Niv. II i KSHK
5. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Guidë turistike”, Niv. III i KSHK
6. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Bar restorant”, Niv. III i KSHK
7. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Reception”, Niv. III i KSHK
8. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Reception (pilot)”, Niv. III i KSHK
9. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Shërbime në hotel dhe restorant”, Niv. III i KSHK
10. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Shërbime të udhëtimit dhe turizmit”, Niv. IV i KSHK
11. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Shërbime motorike”, Niv. III i KSHK
12. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Shërbime xhenerike”, Niv. III i KSHK
13. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Shërbime elektroauto”, Niv. III i KSHK
14. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Teknologji e përpunimit të brumërave”, Niv. III i KSHK
15. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Teknologji e përpunimit të qumështit”, Niv. III i KSHK
16. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Karpenteri, hekurkthim dhe betonim”, Niv. III i KSHK
17. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Mobileri dhe tapiceri”, Niv. III i KSHK
18. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Peshkim”, Niv. III i KSHK
19. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, Niv. II i KSHK
20. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Bujqësi”, Niv. II i KSHK

Aneks 6: Programe lëndore, module profesionale, programe Kursesh të Unifikuara

a) Programe lëndore dhe module profesionale:

1. Rishikimi i programit të përgjithshëm dhe programit analitik të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, për të gjitha drejtimet/profilet mësimore
2. Hartimi i 2 moduleve profesionale: “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm”, kl.11 dhe kl.12, për drejtimin dhe profilet e Hoteleri turizmit

b) Hartim programesh të Kurseve të Unifikuara të Formimit Profesional (10 programe):

1. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Grafik dizajn”
2. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “WEB dizajn”



3. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Riparim kompjuteri”
4. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Menaxhim hoteli”
5. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Operator turistik”
6. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Marketingu digjital”
7. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Poligrafi”
8. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Shërbime në bletari”
9. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Punim xhami”
10. Programi i Kursit të unifikuar të formimit profesional për “Udhërrëfim turistik” (rishikim)

Aneks 7: Materiale mësimore dhe udhëzuesa

a) *Materiale mësimore për lëndët profesionale (25 materiale)*

1. “Marketingu i shërbimeve të sigurimit”, kl.13, (64 orë), të profilit mësimor “Sigurime”, Niveli IV i KSHK
2. “Bazat e komunikimit”, kl.12, (108 orë), të profilit mësimor “Administrim zyre”, Niveli IV i KSHK
3. “Bazat e termohidraulikës”, kl.10, (72 orë) të drejtimit mësimor “Termohidraulikë”, Niveli II i KSHK
4. “Bazat e termohidraulikës”, kl. 11 (68 orë) të drejtimit mësimor “Termohidraulikë”, Niveli II i KSHK
5. “Dizenjimi grafik”, kl.12 (72 orë) të profilit mësimor “Multimedia”, Niveli IV i KSHK
6. “Dizenjimi grafik”, kl.13 (64 orë) të profilit mësimor “Multimedia”, Niveli IV i KSHK
7. “Trashëgimi kulturore dhe historike”, kl. 11 (68 orë), të drejtimit “Hoteleri-Turizëm”, Niv. i II i KSHK
8. “Teknologji konstruksionesh e kallëpesh prej druri”, kl. 12 (68 orë), të profilit "Karpenteri, hekurkthim dhe betonim", Niv III i KSHK
9. “Teknologjia e shfrytëzimit pyjor”, kl. 12 (72 orë), të profilit "Silvikulturë", Niv i IV i KSHK
10. “Florikulturë”, kl. 13 (32 orë), të profilit "Silvikulturë", Niv i IV i KSHK
11. “Marketing”, kl 11 (102 orë), të drejtimit “Ekonomi-Biznes”, Niv. II i KSHK
12. “Psikologji pediatrike”, kl 12 (102) orë, të profilit ”Shërbime kujdesi për fëmijë”, Niv. III i KSHK
13. “Bazat e geriatriisë”, kl 12 (102 orë), të profilit ”Shërbime kujdesi për të moshuar”, Niv. III i KSHK
14. “Baza të dhënash”, kl. 12 (72 orë), të profilit ”Programim”, Niv. IV i KSHK
15. “Baza të dhënash”, kl. 13 (64 orë), të profilit ”Programim”, Niv. IV i KSHK
16. “Programim”, kl. 12 (108 orë), të profilit ”Programim”, Niv. IV i KSHK
17. “Programim”, kl. 13 (64 orë), të profilit ”Programim”, Niv. IV i KSHK
18. “Makinat dhe pajisjet bujqësore”, kl. 12 (108 orë), të profilit “Teknologji bujqësore”, Niv. IV i KSHK



19. “Bazat e blegtorisë”, kl. 10 (72 orë), të drejtimit “Bujqësi”, Niv. II i KSHK
20. “Hyrje në teknologjinë bujqësore”, kl. 11 (68 orë), të drejtimit “Bujqësi”, Niv. II i KSHK
21. “Instalime hidraulike”, kl. 10 (136 orë), të profilit “Instalime hidraulike”, Niv. III i KSHK
22. “Njohuri për mekatronikën e automjeteve“, kl. 12 (108 orë), të profilit “Shërbime mekatronike në automjete“, Niv. IV i KSHK
23. “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12, tema 19 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës” (4 orë)
24. “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm” (modul), kl.11 (68 orë), të drejtimit “Hoteleri-turizëm”, Niv. II i KSHK
25. “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm” (modul), kl.12 (68 orë), të profileve të Niv. III të KSHK, të drejtimit “Hoteleri-turizëm”

b) Udhëzuesa:

1. Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale, në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2022-2023 (në bashkëpunim)
2. Udhëzues për ndryshimet në skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale në vitin shkollor 2022-2023
3. Udhëzues për afatet kohore që lidhen me kualifikimet e mësimeve të kulturës profesionale në AFP, për vitin 2022.